Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

KAÇANIKU

Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

**01 Nr. 16-25229/16**
**Kaçanik, 11.11.016**

Në bazë të nenit 12.2(d) të Ligjit- Për Vetëqeverisjen Lokale(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008) të nenit 58 të Rregullores për Punë të Kuvendit të Komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur me datë 11 Nëntor 2016, mori këtë:

**VENDIM**
**PËR APROVIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE NGA TË GJETURAT E AUDITORIT PËR PVF 2015**

**1.** Me këtë Vendim, Aprovohet Plani i Veprimit 01 Nr. 16-25229/16 -Për zbatimin e Rekomandimeve nga të gjeturat e Auditorit për PVF, 2015, i propozuar nga Kryetari i Komunës prej datës 27.07.2016.

**2.** Në Planin e Veprimit si në pikën 1 të këtij Vendimi, janë paraqitur; veprimet të cilat do t'i merr Kryetari i Komunës dhe zyrtarët tjerë përgjegjës për zbatimin e Rekomandimeve dhe afati kohor për të gjeturat e Auditorit për PVF 2015 dhe i njëjti është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

**3.** Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të MAPL si dhe pas publikimit në Faqen Zyrtare të Komunës.

**4.** Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesën : Kryetari i Komunës dhe zyrtarët tjerë përgjegjës të përcaktuar si në Planin e Veprimit 01 Nr.16-25229/16-Për zbatimin e Rekomandimeve nga të gjeturat e Auditorit për PVF, 2015.

**Me këtë vendim njoftohen:**

1. Kryetari i Komunës/ përmes kësaj njoftohen zyrtarët përgjegjës –zbatues të Planit të Veprimit,
2. Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit dhe
3. Arkivi.

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAČANIK
REPUBLIKA KOSOVA

Kryesuesi i Kuvendit
Xhelal Gashi

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

**Zyra e Kryetarit**

**01 – Nr.** 16-25229/16
**Kaçanik; 27.07.2016**

| | |
|---|---|
| PËR/ZA/TO: | ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM ZAP – DREJTORIT Z. BESNIK OSMANI |
| CC: | Zv. Drejtorit të ZAP z. Flamur Beqiri |
| PËRMES/PREKO/THROUGH: | Bahri Selimi – Drejtor për Buxhet e Financa |
| NGA/OD/FROM: | Besim Ilazi – Kryetar i Komunës-ZKA |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Dorëzimi i Planit të Veprimit për zbatimin e Rekomandimeve nga të gjeturat e Auditorit për PVF' 2015 |

***Të nderuar,***

*Bashkëngjitur shkresës po iu dërgojmë Palnin e Veprimit për zbatimin e Rekomandimeve nga të gjeturat e Auditorit për PVF' 2015.*

***Me respect;***

| Komponenta e Auditimit | Rekomandimet | Aktivitetet e pritura | Datat e përcaktuara | Bartësit / Drejtoritë përkatëse |
|---|---|---|---|---|
| **Çështja 1 – Zbatimi i rekomandimeve nga viti paraprak – Prioriteti i lartë** | Kryetari i komunës duhet të rishikoj Planin e Veprimit për adresimin e rekomandimeve të vitit 2014 dhe atyre më herët. Ky plan duhet të përcaktojë një kornizë të arsyeshme kohore të zbatimit, personel përgjegjës dhe modalitet në aplikim, duke u fokusuar fillimisht në fushat e rëndësisë së lartë, aty ku janë identifikuar dobësi domethënëse. Progresi i planit duhet të monitorohet direkt nga Kryetari i Komunës. | Jemi munduar që çështejt e gjetura të vitit të kaluar ti adresojmë dhe ti përmirësojmë këto të gjetura por qëllimi jonë është që të gjeturat në plotni të adresohen dhe të kemi eleminim të dobësive apo mangësive të cekura nga auditori që me disa nuk jemi pajtuar si të gjetura komunale. Janë marrë për bazë të gjitha rekomandimet e gjetura nga auditori i jashtëm dhe presim rezultate shumë më të mira në prezentimin e PVF 2016. | Tremujori i 4/2016 | Kryetari i Komunës,<br><br>Të gjitha drejtoritë dhe njësitë tjera organizative. |
| **Çështja 2 – Lista kontrolluese e vetëvlerësimit – Prioritet i Mesëm** | Kryetari duhet të sigurojë që lista kontrolluese e vetë-vlerësimit është plotësuar me objektivitet dhe është dokumentuar për të identifikuar dobësitë dhe për ti zvogluar ato në mënyrë të përshtatshme, siç kërkohet nga Ministria e Financave e Republikës së Kosovës.. | Do ta kemi parasyshë listen e pyetësorit të vetëvlerësimit si mjedisi i kontrollit, menagjimi i riskut, aktiviteti i kontrollit, për të mbështetur rregullimin efektiv të qeverisjes . | Përhershëm | Kryetari i Komunës,<br><br>Të gjitha drejtoritë dhe njësitë tjera organizative. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Çështja 3 – Proceset e llogaridhënies– Prioriteti i lartë** | Kryetari i Komunës duhet të sigurojë një rishikim të kërkesave ekzistuese të llogaridhënies dhe raportimit të drejtorive komunale për të siguruar angazhime të përmirësuara për të arritur objektivat e veçanta gjatë një viti. | Do të marrim veprime të mëtutjeshme të llogaridhënjës për të siguruar arritjen e objektivave komunale gjat vitit 2016 | Përhershëm | Kryetari i Komunës<br>Të gjitha drejtoritë dhe njësitë tjera organizative. |
| **Çështja 4 – Moszbatimi i kërkesave për menaxhimin e riskut – Prioriteti i lartë** | Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që procedurat dhe sistemet e menaxhimit të riskut janë krijuar dhe janë funksionale. Për më tepër, përgjegjësia për menaxhimin e riskut është deleguar direkt në një drejtori përkatëse që të sigurojë raportimin mujor mbi zbatimin e kërkesave në këtë fushë dhe të siguroj se risqet janë duke u menaxhuar. | Do te mundohemi që sistemi i menagjimit të riskut të jëtë funksional duke identifikuar, vlerësuar, efektet, , masat dhe të gjitha këto duke I inkorporuar në plan veprimi për adresimin e rreziqeve . | Përhershëm | Kryetari i Komunës<br>Të gjitha drejtoritë dhe njësitë tjera organizative. |
| **Çështja 5 – Dobësi në Kontrollet Menaxheriale – Prioriteti i lartë** | Kryetari i Komunës duhet të rishikojë masat ekzistuese të qeverisjes së përgjithshme dhe cilësinë e raportimit të brendshëm të Komunës. Kërkesat pazbatuara duhet të adresohen deri në fund të vitit 2016. Cilësia e raportimit dhe mbikëqyrjes buxhetore duhet të shqyrtohet në mënyrë kritike dhe sistematike për të siguruar arritjen e objektivave të Komunës. | Do te bëjmë përpjekje që sistemi i menagjimit të riskut të jëtë funksional duke identifikuar, vlerësuar, efektet, masat dhe të gjitha këto duke i inkorporuar në plan veprimi për adresimin e rreziqeve . | Përhershëm | Kryetari i Komunës<br>Të gjitha drejtoritë dhe njësitë tjera organizative. |
| **Çështja 6- Funksionimi i planit të auditimit sipas** | Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që Departamenti i Auditimit të Brendshëm ka burime të përshtatshme dhe të mjaftueshme njerëzore. Për më tepër, Kryetari duhet të sigurojë që aktiviteti i ardhshëm i AB duhet të udhëhiqet në drejtim të zhvillimit dhe zbatimit të strategjisë së auditimit | Edhe pse nuk jemi pajtuar me kete te gjetur do të siguro që komiteti i auditimit të jetë funksional dhe të kryen | Tremujori i 3-të | Kryetari i Komunës , Auditori i NJAB |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Njësisë së Auditimit dhe Komitetit të Auditimit - Prioritet i lartë** | të bazuar në risk. Gjithashtu, në mënyrë që përfitimet të jenë të dukshme, Kryetari duhet të marrë masa për zbatimin e rekomandimeve të AB brenda Komunës. | detyrat e veta siq kërkohet me ligj të vendos politika dhe procedura të duhura për të siguruar një standard të lartë të monitorimit dhe zbatim të sistemit të kontrollit të mbrendshëm në proqesin e raportimit financiar dhe zbatimin e rekomandimeve të NJAB. | | |
| **Çështja 7 – Dobësitë sistematike në prokurim – Prioriteti i lartë** | Kryetari duhet të identifikoj shkaqet rrënjësore të mangësive dhe të ndërmarrë masat e duhura për të siguruar se kërkesat e ligjit te prokurimit janë zbatuar plotësisht. | Zyra e prokurimti do të bëjë një plan të veprimit për elminimin e dobësive te të gjeturave të Auditorit me qëllimin e rritjes së perfomancës në punë dhe zvoglimit të rrezikshmërisë në procedurat e prokurimit dhe punëve tjera . | TM3/ 2016 | Kryetari i Komunës Udhëheqësi i Zyrës së Prokurimit |
| **Çështja 8 – Mungesë e dokumentacionit të duhur– Prioriteti i lartë** | Kryetari duhet të siguroj që Komuna të ndërmarrë hapa të mëtutjeshme për përmirësimin e kontrolleve mbi shpenzimet dhe pagesat që ato të jenë në pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret përkatëse. | Pagesa e transfereve kapitale në bashkëfinancim me donatorët e jashtëm pë projekte tëcaktuara, po kushtëzohet me këtë formë të bashkëfinancimit. | Përhershëm. | Kryetari dhe Drejtori i DEFZH. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Çështja 9 – Dosjet e Personelit – Prioriteti i mesëm** | Kryetari duhet të sigurojë që Komuna të ndërmarrë hapa të mëtutjeshëm për përmirësimin e kontrolleve mbi dosjet e personelit në mënyrë që dosjet të jenë të kompletuara dhe organizuara mirë dhe të marrë masa në lidhje me nënshkrimin e listës së pagave. | Edhe pse me këtë të gjetur nuk jemi pajtuar se dosjet e personelit nuk mbahen si duhet por në planin e veprimit ne do të angazhohemi dhe do ti kemi parasysh të gjeturat e auditorit të jashtëm . | TM3 /2016 | Kryetari i KomunёS,Shefi i personelit |
| **Çështja 10 – Të hyrat nga tatimi në pronë– Prioriteti i lartë** | Kryetari i Komunës duhet të ndërmarrë këto hapa:<br><br>Të ndërmaerrë hapa për të përmirësuar sistemin e faturimit, dhe të kontabilitetit në mënyrë që të sigurojë kontrolle efiçiente dhe efektive në faturim, dhe në të hyra. Përmirësimi i procedurave lidhur me sisteme të tilla do të mundësonte menaxhmentin të monitoroj dhe të menaxhoj risqet e mëdha, dhe të siguroj që vendimet lidhur me buxhetimin, planifikimin dhe arkëtimin e të hyrave bëhen në mënyrë të duhur. Të sigurohet që anketimet dhe kushtëzimi i provizionimit të shërbimeve bëhet siç kërkohet me Udhëzimin Administrativ Nr. 03/2011 dhe Nr. 07/2011. | Edhe pse Komuna ka një sërë kontrollesh për mbledhjen e të hyrave të saj, megjithatë pajtohemi se ekziston nevoja për përmirësimin në disa procese për ë siguruar saktësinë dhe plotësinë e arkëtimit të të hyrave.<br><br>Qëllimi i Zyrës Komunale të Tatimit në Pronë (ZTP) dhe i organizatës buxhetore në tërësi është që t'iu përmbahemi rregulloreve dhe ligjeve në fuqi dhe do të bëjmë përpjekje që të gjeturën e mos rianketimit të 1/3 së të të gjitha pronave sipas Udhzimit Administrativ Nr.03/2011 ta zbatojmë rekomandimin duke angazhuar ekipe të veçanta nga stafi i paangazhuar plotesisht apo permes kontraktimeve tjera të cilët përmes punës në teren do të | Përhershëm | Zyra e Kryetarit të Komunës,<br><br>Drejtoria e DEFZH-së, (Zyra Komunale e Tatimit në Pronë) |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | bëjnë verifikimin e pronave konform UA Nr. 03/2011.<br><br>Poashtu do të punohet në drejtim të regjistrimit të kontratave të shitëblerjes ne menyrë të percaktimit të vleres sa me drejtë të pronave. | | |
| **Çështja 11 - Regjistri i pasurisë kapitale – Prioritet i lartë** | Kryetari duhet të sigurojë regjistrimin në kohë dhe të saktë të të gjitha pasurive në regjistrat përkatës, në përputhje me kërkesat e rregullores 02/2013. Gjithashtu duhet të sigurojë që pasuritë kapitale të cilat regjistrohen përmbajnë informacion të plotë, duke përfshirë datën kur pasuria është vënë në përdorim, në mënyrë që llogaritja e zhvlerësimit të mund të kryhet me saktësi, si dhe të përcaktojë statusin e pronësisë. | Regjistrimi i pasurisë kapitale ka qenë i barazuar dhe nuk jemi pajtuar me rekomandimin e auditorit sepse në regjistrin e ofruar ka datë të pasurisë edhe në sistemin e Free Balancit kanë datën e saktë edhe të lëshimit të faturës por edhe të bërjes pagesë të asaj pasurie e që është document bazë për përllogaritjen e fillimit të amortizimit të saj pasurie , amortizimi bëhet nga sistemi I Frebalancit nga Ministria e Financave- Departamenti i Thesarit. Gjatë viit fiskal 2015 në komunën tonë është bërë një angazhim mjaftë i madhë i regjistrimit të aseteve komunale dhe si rezultat në Raportin Financiar të perfundimit te vitit në shënimin 31 të Raportit të PVF kemi paraqitur vlerën e | 31.12.2016 | Kryetari i Komunës,<br><br>Drejtoria e DEFZH-së (Zyrtari i regjistrimit të Paurisë) |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | pasurisë jofinanciare prej 46 milion në vlerë neto nga 50 mijë euro sa kanë qenë të regjistruara në fillim të vitit apo perfundim te vitit fiskal 2014. Vlerësojmë se ende kemi punë për të bërë në këtë drejtim, do të angazhohemi edhe më tutje nëregjistrimin dhe vlerësimin e këtij procesi mjaftë të ndërlikuar edhe në vitin 2016 dhe do të mundohemi ti identifikojmë, vlerësojmë dhe regjistrojmë çdo pasuri e identifikuar deri në fund të vitit. | | |
| **Çështja 12 - Inventarizimi i pasurisë kapitale- Prioriteti i lartë** | Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që inventarizimi i pasurive kapitale jo-financiare është kryer në pajtim me Rregulloren në fuqi për pasuritë jo-financiare të Organizatave Buxhetore dhe për të siguruar se inventarizimi bëhet në baza vjetore. | Do të angazhohemi me formimin e komisionit për inventarizimin e pasurisë kapitale mbi 1000 € dhe nën 1000 € dhe duke ju përmbajtur rregullores Mf-Nr 02/2013 për të identifikuar gjendjen reale dhe faktike të aseteve komunale. | 31.12.2016. | Kryetari i Komunës- Përmes Komisioneve të Formuara me Vendim.<br><br>DEFZH – ZKF, |
| **Çështja 13 - Mungesë e dokumentacionit të pronësisë dhe informacioneve për investimet e bëra nga palët e treta - Prioriteti i** | Rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të siguroj se Komuna është duke bërë përpjekje maksimale për sigurimin e të dhënave nga palët e treta, me theks të veçantë në ato palë që dihet se kanë kryer investime të rëndësishme në komunë. Të dhënat e marra duhet të paraqiten si duhet në regjistrin e pasurive të Komunës. Praktika më e mirë do të kërkojë një barazim vjetor bazë të të dhënave në mes të palëve të treta dhe Komunës për investime në Komunën për vitin përkatës. | Do të rritet niveli i angazhimit te Komunes ndaj Ministrive dhe Financuesëve tjerë, per te siguruar dokumentet e nevojshmepër bartjen – transferimin e pronësisë së pasurisë të financuar ato në drejtim te regjistrave | 31.12.2016. | Kryetari i Komunës,<br><br>Drejtoria e DEFZH-së (Zyrtari i regjistrimit të Paurisë) |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **lartë** | | komunale. | | |
| **Çështja 14 – Depozitimi i parasë së gatshme-Prioriteti i Mesëm** | Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet se depozitat e përditshme të parasë dhe kontrollet janë kryer ashtu siç kërkohet nga legjislacioni në fuqi. | Depozitimi në baza ditore e jo javore siq është vepruar deri më tani përkundër shpenzimeve të panevojshme që mundë bëhen në emër të provizioneve me rastin e depozitimit të parasë në baza ditore. | Përherëshme. | Kryetari i Komunës,<br><br>DEFZH |
| **Çështja 15 – Vjetërsia e llogarive të arkëtueshme – Prioriteti i lartë** | Kryetari i Komunës duhet të sigurohet se Komuna ndërmerr hapa dhe të hartoj një plan të detajuar lidhur më arkëtimin e borxheve të vjetra. | Meqë pjesa më e madhe e zërit LL/A ka të bëjë me obligimet e qytetareve ndaj Tatimit në Pronë, komuna do te angazhohet që deri në datën e fundit (03.09.2016) të shfuqizimit të Ligjit mbi faljen e Borgjeve Publike të bëjë përpjekje që ky Ligj të zbatohet në masë sa më të madhe si nga aspekti i shtimit te arkëtimit te të hyrave vetanake komunale, pastrimit të listës së LL/A dhe në të mirë të qytetarëve nga falja që mundë gëzojnë. Angazhimi kryesisht do të bëhet në drejtim të informimit te qytetareve per të drejtat që i jep Ligji në fjalë dhe apelimit të për shlyerje të obligimeve të tyre.<br><br>Pjesa tjetër e LL/A të cilat nuk trajtohen me Ligjin mbi Faljen | 31.12.2016. | Zyra e Kryetarit të Komunës,<br><br>Drejtoria e DEFZH-së, (Zyra Komunale e Tatimit në Pronë dhe Qendra e Regjistrimit të Bizneseve)<br><br>Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit (Shfrytezimi i Prones Komunale) |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | e borgjeve, komuna së pari do të angazhohet ne gjetjen e menyrave të inkasimit të rregullt të tyre e më pas do të bëjë analiza mbi mundësinë apo jo të arkëtimit të tyre dhe pas identifikimit apo klasifikimit si "borgje të këqija" të asaj pjese të LL/A ,do të bëjë edhe heqjen e tyre nga regjistrat komunale permes procedurave ligjore tjera. | | |
| **Çështja 16 - Borxhet e papaguaran - Prioriteti i lartë** | Kryetari duhet të sigurojë që Komuna do të ndërmarrë hapa të mëtutjeshëm dhe të zhvilloj plane veprimi për të bërë pagesat brenda periudhës së kërkuar. | Borgjet janë reale, do të mundohemi të jemi të fokusuar që të jemi në plotni të zbatimit të ligjit që mos të mbeten mbi 30 ditë faturat e papaguara . | 31.12.2016 | Kryetari i Komunës |